



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 2598/1 prot.

Tiranë më 18.12.2024

Lënda: Mendim mbi një projektvendim

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj me nr. 9201/5 prot., datë 13.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 2598 prot., datë 16.12.2024, me anë të të cilës dërgoni për mendim projektvendimin për miratimin në parim të “*Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit*”, së bashku me relacionin shpjegues.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të mësipërme, duke qenë se projektvendimi parashikon nënshkrimin e një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet shteteve palë, si dhe në të janë referuar rregullat dhe parimet bazë mbi mbrojtjen e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit e vlerëson projektvendimin të hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi